



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1072 prot.

Pukë, më 24.05. 2022

PROJEKT - VENDIM

Nr. 03 Datë 24.05 2022

PËR DHËNIE TITULLI QYTETAR NDERI I BASHKISË PUKË

Z. Skënder Shaban Haxhi Thaçi (pas vdekjes)

Këshilli i Bashkisë Pukë në zbatim të Nenit 54, pika "m" të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Të nenit 3, pika 1; nenit 14, pika 1; nenit 15, pika 1/a dhe 2; nenit 16, pika 1; nenit 17; nenit 18; nenit 19; nenit 20, pika "ç"; të ligjit nr. 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 113, pika "dh", të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me Propozim të Kryetarit të Bashkisë

V E N D O S I

1. T'i jepet titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë, **Z. Skënder Shaban Haxhi Thaçi (pas vdekjes)** me motivacionin:

"Për punë të përkushtuar në procesin mësimor-edukativ të nxënësve , si dhe në rritjen e nivelit drejtues të shkollave të rrethit të Pukës në vitet 1970-1990, duke u bërë një shembull për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave të Pukës"

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, i ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

Drejtor DMBNJ
Emirjona Pergjegjaj

Jurist
Aida Sinani

K R Y E T A R I
Gjon Gjonaj

Ne mungese dhe me urdher

Zv.kryetari
Ershele Gjoni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. _____ prot.

Pukë, më ____ . ____ . 2022

Relacion

PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR DHËNIE TITULLI “QYTETAR NDERI”

Z. Skënder Shaban Haxhi Thaçi (pas vdekjes)

Mbështetur në ligjin nr. **139/2015** “Për vetëqeverisjen vendore”, në ligjin **112/2013**, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, (ndryshuar me ligjin nr. **10/2015**, datë **19.2.2015**), pas vlerësimit të kërkesës së bërë për dhënien e titullit qytetar nderi **z. Skënder Shaban Haxhi Thaçi** me qëllim që të vlerësohet puna dhe kontributi i tij , Këshilli i Bashkisë duke konsideruar propozimin , ju propozon anëtarëve të Këshillit Bashkiak që të vlerësohet figura tij dhe personaliteti, duke ju dhënë titulli i nderit në shenjë respekti dhe mirënjohjeje publike për të gjithë kontributin dhe përkushtimin e tij në fushën e arsimit. I lindur në 1937 në Kukës . Në 1961 mori një bursë për arsimin e lartë , dega matematikë – fizikë dhe në 1965 filloi të jëpte mësim në shkollën 7-vjeçare të Kabashit . Në kushte mirënjohjeje për punën e tij u emërua drejtor në shkollën e mesme të Lufit dhe drejtues i sektorit të kualifikimit të mesuesve . Duke parë aftësitë e tij u emërua dhe drejtues i shkollës “ Migjeni” duke rritur nivelin shkencor pedagogjik të shkollës.

Me propozim të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

T’i jepet titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Pukë, **z. Skënder Shaban Haxhi Thaçi (pas vdekjes)** me motivacionin:

“Për punë të përkushtuar në procesin mësimor-edukativ të nxënësve , si dhe në rritjen e nivelit drejtues të shkollave të rrethit të Pukës në vitet 1970-1990, duke u bërë një shembull për mesuesit dhe drejtuesit e shkollave të Pukës .”

Ky titull i jepet në shenjë nderimi dhe vlerësimi për të gjithë punën dhe kontributin e dhënë në fushën e arsimit, **z. Skënder Shaban Haxhi Thaçi (pas vdekjes)**.

1. Për të gjitha meritat e lartpërmendura propozohet ti akordohet titulli “Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë”.

Drejtore Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
Emirjona Pergjegjaj

Skënder Shaban Haxhi Thaçi

mësues e drejtor i dalluar i shkollave Kabash, Luf e Pukë

- Kukës, më 1937 - Pukë, më 1995 .-

Skënder Shaban Thaçin e karakterizonte një natyrë e qetë, i përmbajtur, i sinqert në shoqëri dhe në detyrën e tij mësimore - edukative në shkollë e jashtë saj : si me nxënësit dhe prindërit e tyre Cilësi këto të trashiguara nga prindërit e tij. Kështu e ama , Xheve Asllanaj, bi e Zotnive të Pukës. P kështu edhe babai i tij Shaban Haxhiaj i Thaçit të lballës., njeri i edukuar, i cili pat mbaruar shkollën mesme si konviktor i Konviktit "Malet Tona" në Shkodër, ku dallohej për urtësi e sjellje shembullore.

Skënderi pati fatkeqësinë të rritej jetim që në moshën 6-vjeçare me tre vëllezërit e tjerë të mitur sepse babain ia vranë më 1943 në Prizren, ku punonte si sekretar komuneje, i emruar nga Prefektura e Kosovës me qender në Kukës. Një hasmëri me mirakajt ishte që prej vitit 1926. Sado që Haxhi Thaçi, gjyshi i Skënderit, iu la mirakajve me Be, ata nuk ia njohën Benë, duke vranë më 1929 Dasl Hxhinë, axhën e Skënderit. Shabani për t" i shpëtuar hasmërisë në vazhdim, si martohet në Pukë me Xheven e Tarit, Asllanaj, u vendos në Kukës, ku filloi jetë të qetë dhe po u gëzohej të 4 djemëve, për të cilët kujdesohej për rritjen e tyre të edukuar dhe të mbrojtur prej hasmërisë së mirakajve.


Skënderi e përjetonte me ngashrim vrasjen e të atit dhe kujdesin e pareshtur të nënë Xheves, që rriti me vështërsi të katër djemtë, sado që u kthye në Pukë afër gjinisë e përkrahjes së tyre. Pushtet lokal i Pukës e përkrahu Sënderin dhe vëllezërit e tij jetima dhe si nipa të familjes Asllanaj me kontribut të veçantë për LNÇL, u dha mundësi shkollimi e punësimi. Kështu vëllai i madh, Hysnia i zgjodh Sekretar i Komitetit të Rinisë rrethit Pukë, Nazmiu ekonomist i mesëm, kurse vëllai i vogël Muharremi, teknik PTT Pukë. Ndërsa Skënderi sapo mbaroi shkollën pedagogjike, u goditë nga një fatkeqësi tjetër , i vdes vëllai i madh nga sëmundje e pashërueshme. Të gjitha këto Skënderi i përjetoi me trishtim, duke qëndruar i heshtur dhe i mbyllur. Me gjithatë nuk i mungonte kujdesi i nënë Xhevës, dajëve të cilët e ndihmuan të merrte më 1961 një bursë për arsim të lartë, dega matematikë fizikë. Më 1965 filloi të jepte mësim në shkollën 7-vjeçare të Kabashit. Në Kabash gjeti mbështetje e prindërve të nxënësve dhe të kolektivit mësimor. Tani Skënderi filloi të gjallërohej dhe të kishte rezultate të mira me nxënësit, aq sa për mungesë mësuesish në komisione provimesh të arsimtarëve me korespondencë është caktuar në shkollën e mesme " Migjeni " Pukë për konsultime dhe provime në vitin 1965. Në këto kushte mirënjohjeje për punën e tij , u emërua Drejtor i Shkollës së mesme Luf dhe drejtues i sektorit të kualifikimit mësuesve, i quajtur Rrethi Metodik i mësuesve të rrethit Pukë për matematikë – fizikë. Duke parë aftësitë profesionale të lëndëve mësimore që jepte dhe suksese pedagogjike, emërohet Drejtor i Shkollës së mesme " Migjeni", Pukë, ku rriti nivelin drejtues të


Shkollës e të nivelit shkencor pedagogjik të mësuesve dhe të nxënësve të kësaj shkolle deri sa 1962 doli në pension i nderuar dhe i respektuar.


Sa më sipër mendojmë që Skënder Shaban Thaçi të shpallet QYTETAR NDERI I BASHKISË PUKË me këtë motivacion:"


"Për punën të përkushtuar në procesin mësimor – edukativ të nxënësve, si dhe në rritjen e nivelit drejtues të shkollave të rrethit Pukë në vitet 1970 – 1990, duke u bërë një shembull për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave të Pukës."

Propozuesit: 1. Xhemal Meçi, Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë, Mjeshtër i Madh, koleg arsimi;


2, Ramazan Ringaj, Drejtor QKF Pukë, Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë, ish-nxënës i tij


3. Gjon Frroku, Kryetar i Komitetit të Veteranëve të LNÇL Pukë, Ish-kryetari Këshillat të fshatit të Bashkuar Qerret – Luf, kur Skënderi ishte drejtor shkolle në Luf;


4. Fran Vuka, Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë, regjisor, ish- nxënës i Skënder Thaçit


5. Riza Hoxha, Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë, koreograf i mirënjohur, koleg arsimor me Skënder Sh. Thaçin.

Pukë, më 23 maj 2022,